

SALI KADRIA

**KRIZA HUMANITARE E VITEVE 1923 - 1924 NË VISET
E SHQIPËRISË SË VERIUT - NDIHMA E QEVERISË
BRITANIKE DHE E LIDHJES SË KOMBEVE**

Shenjat e krizës së urisë në mesin e popullsisë së viseve të Shqipërisë së Veriut u dukën që në vitin 1922. Gjatë vitit 1923, kriza u thellua më tej, ndërsa në pjesën e parë të vitit 1924, ajo mori përmasat e një krize të vërtetë humanitare. Rreth 200 mijë shqiptarë të viseve veriore të Shqipërisë gjendeshin në prag të vdekjes, për shkak të zisë së bukës. Çështja e krizës së urisë që u shfaq në mesin e banorëve të viseve të Shqipërisë së Veriut në vitet 1923-1924, është trajtuar nga studiues shqiptarë, si Dhimitër Kotini, Burhan Çiraku, Hysen Kordha¹, por edhe nga autorë të huaj si Joseph Swire, Nina Smirnova e ndonjë tjetër². Por, me sa jemi në dijeni, ajo nuk është bërë më parë objekt i ndonjë studimi të veçantë. Në botimin “Historia e Shqipërisë”, vëllimi i dytë, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë të vitit 1984, vihet re përpjekja për të paraqitur krizën e rëndë të urisë³, por fokusi i studiuësve u përqendrua më tepër tek aspekti politik i çështjes, pra, tek “Lëvizja revolucionare” e popullsisë shqiptare për përmbysjen me forcë të regjimit politik në fuqi, se sa në shqyrtimin në një prizëm më

¹ Dhimitër Kotini, “Të dhëna mbi gjendjen e vështirë ekonomike të masave punonjëse të fshatit dhe mbi qëndresën e tyre në vitet 1921-1923”, në *Mbi Lëvizjen Kombëtare dhe Demokratike Shqiptare në vitet 1918-1924*, Tiranë: 1966, f. 183-184; Burhan Çiraku, “Çështja agrare në parlament në vitet 1921-1923”, në *Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924*, Tiranë: 1977; Hysen Kordha, “Lëvizja e marsit 1922”, në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1976, f. 129-163; Hysen Kordha “Vështrim mbi lëvizjen e malësorëve të veriut në vitet 1922-1923”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 1987, f. 53-72.

² Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 321; Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, përkthyer nga Korab Hoxha dhe Fatmir Mborja, Tiranë: Ideart, 2004, f. 116-117.

³ *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1984, f. 82-85.

të gjerë, të shkaqeve dhe rrethanave të kësaj gjendjeje të rëndë, nga e cila vuante prej një periudhe të gjatë popullsia shqiptare. Edhe në botimin e fundit “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i tretë, botim i Institutit të Historisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të vitit 2002, ka përpjekje për të pasqyruar në vija të përgjithshme gjendjen ekonomike e shoqërore të Shqipërisë. Ndoshta për shkak se botimet e kësaj natyre, trajtojnë një numër të madh çështjesh brenda një periudhe të ngjeshur kohore, edhe kësaj here kriza e rëndë e urisë që përfshiu një numër të konsiderueshëm të popullsisë shqiptare është trajtuar në mënyrë tangente. Të dhënat dokumentare, kryesisht britanike, janë të pasura dhe na japin mundësi, për të hedhur dritë mbi këtë krizë të thellë humanitare që arriti kulmin në vitet 1923-1924.

Shkaqet e krizës humanitare në viset e Shqipërisë së Veriut

Gjatë viteve 1920-1924, gjendja ekonomike e popullsisë shqiptare paraqitej e vështirë. Një pjesë e faktorëve që ndikuan në këtë gjendje ishin të trashëguar, ndërsa të tjerë ishin të brendshëm e të jashtëm që vepruan nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore deri në vitin 1924, të cilët e përkeqësuan më tej gjendjen. Faktorët e trashëguar që ndikuan në acarimin e kësaj krize ishin të shumtë. Së pari, kufijtë politikë që iu imponuan Shqipërisë në vitin 1913, e vendosën ekonominë e shtetit shqiptar nën varësinë e drejtpërdrejtë të Serbisë dhe të Greqisë. Mjaftonte që këto dy shtete të mbyllnin kufijtë e tyre me Shqipërinë, duke bllokuar furnizimin me drith dhe ky akt u jepte atyre mundësinë që të rrezikonin nga uria, pothuajse gjysmën e popullsisë shqiptare⁴. Së dyti, Shqipëria vuajti së tepërmi nga shkatërrimet dhe rekuizimet e forcave ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore, nga luftërat e shpeshta me fqinjët si dhe nga mosmarrëveshjet e brendshme politike që filluan në vitin 1913 e nuk patën të sosur deri në këtë periudhë. Së treti, mungesa e rrjetit të rrugëve të transportit që lidhnin krahinat e veriut të vendit me ato të jugut ishte një faktor i rëndësishëm i prapambetjes dhe i varfërisë së madhe në Shqipëri.

Krahas faktorëve të mësipërm, ndikuan edhe faktorë të tjerë jo më pak të rëndësishëm, të cilët e acaruan edhe më tepër krizën. Gjendja e

⁴ Dhimitër Pasko, *Shënime ekonomike* (Pjesa “Kosova në ekonominë shqiptare”), Tiranë: 1944, f. 35.

rëndë e trashëguar në sektorin e bujqësisë, mënyra pothuajse primitive e punimit të tokës që vazhdoi të mbizotëronte në fshatrat shqiptare, ndikoi drejtpërdrejtë që kjo pjesë e popullsisë shqiptare të mbetej në një situatë krize të vazhdueshme. Ndonëse numri i banorëve që jetonte në zonat rurale përbënte mbi 90 për qind të popullsisë së Shqipërisë, gjendja e saj ekonomike e sociale e kësaj pjese të popullsisë shqiptare dhe veçanërisht e banorëve të viseve malore të Shqipërisë së Veriut mbeti mjaft e rëndë⁵.

Në vitin 1922, u ndie mungesa e misrit që përbënte ushqimin bazë të popullsisë. Ajo u shoqërua me shfaqjen e zisë së bukës në popullsinë e disa krahinave të Shqipërisë⁶. Edhe gjatë vitit 1923, banorët e mjaft krahinave të vendit u gjendën nën kërcënimin e urisë. Zija e bukës u përhap pothuajse në të gjithë vendin, duke filluar nga banorët e Malësisë së Madhe në veri e deri në krahinat e Kurveleshit, Tepelenës, Mallakastrës dhe Himarës në jug të vendit⁷. Gazeta “Populli” shkruante se “zia e bukës ka nisë me ba viktimë. Nuk ka shpi që mund të ketë 30 kg bukë rezervë. Merreni me mend ku ka arrit halli i malësorit”⁸.

Mbledhja e taksave dhe e tatimeve ishte një domosdoshmëri për ekzistencën e shtetit shqiptar, por meqenëse ajo nuk ishte “në përpjesi me fuqinë financiare të popullit”, kthehej në një barrë të rëndë për fshatarësinë e varfër shqiptare⁹. Ishte kjo arsyeja kryesore që marrëdhëniet midis fshatarësisë dhe organeve tatimore të shtetit shqiptar u gjendën në një kontradiktë të vazhdueshme. Në kushtet kur nuk arrihej të plotësoheshin nevojat për misër brenda vendit, qeveria dhe sipërmarrësit shqiptarë detyroheshin të importonin nga jashtë sasi të konsiderueshme drithi.

⁵ Gazmend Shpuza, “Një vështrim mbi shfrytëzimin e fshatarësisë në fillim të shek. XX me anë të detyrimeve shtetërore e çifligare dhe të fajdesë”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1975, f. 62.

⁶ Hysen Kordha – Tefta Gjoleka, *Shoqëria “Bashkimi” (1922-1925)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 16.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 195-196; N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 119.

⁸ *Populli*, Shkodër, 31 mars 1923, f. 2.

⁹ “Taksat e Shtetit Civil”, në *Drita*, nr. 86-18, Gjirokastrë, 25 qershor 1922, f. 1.

Në fillim të viteve 20-të shek. XX, në duart e shtresave të pasura në Shqipëri gjendeshin rreth 50-100 milionë franga ari në monedhë¹⁰. Kjo sasi monedhe mund të ishte një burim financiar me vlerë për të kryer investime, mirëpo, sipërmarrësit shqiptarë hezituan të kryenin investime, për shkak të trazirave politike të shpeshta që ndodhnin në vend, mungesës së përvojës së tyre për realizimin e projekteve të përparuara, por edhe nga frika e konkurrencës së kapitalit të huaj¹¹. Meqenëse Shqipëria nuk kishte bankë dhe një monedhë kombëtare, një sasi e konsiderueshme monedhe në metal të çmuar, dilte çdo vit jashtë vendit. Kjo solli dobësimin e thesarit të shtetit shqiptar si dhe ndikoi në thellimin e defiçitit tregtar të Shqipërisë në shkëmbimet me jashtë¹². Në kushtet e mungesës së një banke kombëtare, përhapje mori dukuria e fajdesë.

Gjatë vitit 1923, qeveria shqiptare shpenzoi dhjetë mijë napolona për importimin e drithit, por shumica e akorduar prej saj ishte e papërfillshme dhe nuk arriti të parandalonte vdekjen nga uria të banorëve të kësaj pjese të vendit¹³. Krahas vështirësive dhe faktorëve objektivë që ndikuan në përkeqësimin e situatës, kriza humanitare në mesin e banorëve të viseve veriore u thellua edhe për shkak të administrimit të dobët nga ana e drejtuesve dhe funksionarëve të lartë të shtetit shqiptar. Në vend, nuk u realizuan reforma të thella ekonomike; buxheti i shtetit arriti një defiçit të madh për shkak të korrupsionit dhe abuzimeve me taksat që mblidheshin nga populli; si dhe numri i punonjësve në administratë dhe në ushtri mbeti tepër i madh¹⁴.

Sensibilizimi i qeverisë së Britanisë së Madhe për krizën dhe përmasat e saj

¹⁰ Albert Calmès, *La situation économiques et financière de l'Albanie*, Genève: 1922, f. 21.

¹¹ Iljaz Fishta – Veniamin Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë: 8 Nëntori, 1983, f. 30-31.

¹² *Statistikë e Tregtisë së Jashtme, viti 1927*, botim i Ministrisë së Financave, Tiranë: Nikaj, maj 1928, f. IX.

¹³ *The British National Archives*, (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/9642, H. C. A. Eyres për Markezën Curzon të Kedleston, K. G., Durrës, 11 janar 1924, No. 1, (12/412/6).

¹⁴ Beqir Meta, *Politika tatimore e shtetit shqiptar 1925-1939*, Tiranë: Shkenca, 1999, f. 20.

Alarmin për krizën e thellë humanitare që kishte përfshirë popullsinë e viseve të Shqipërisë së Veriut, e dha për herë të parë H. Eyres, ministri i Britanisë së Madhe në Shqipëri. Me një vështrim të hollë prej një diplomati të shquar, me një nivel të lartë qytetar, por edhe me një ndjenjë të fortë humanizmi, H. Eyres, informoi qartë drejtuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe (Foreign Office) mbi gjendjen e rëndë të kësaj pjese të popullsisë së Shqipërisë. “Ajo që ka prekur thellësisht ndjenjat e mia”, - shkruante ai, - “është dinjiteti, kurajoja dhe shpirti i mosnështrimit me të cilën këta malësorë të varfër përballen me vështirësitë më ekstreme”. Eyres ishte i ndërgjegjshëm se nuk ishte momenti i përshtatshëm për t’i kërkuar ndihmë qeverisë së tij, por megjithatë, ai theksonte se “është e pamundur të qëndroj pranë tyre [shqiptarëve] dhe të mbetem indiferent përballë kësaj varfërie, e cila mbizotëron në këto krahina”¹⁵.

Edhe humanistja britanike M. Edith Durham, informoi hollësisht Harold Nicolson, funksionar i lartë në Foreign Office, mbi gjendjen e popullsisë shqiptare. Një ditë më pas, ajo iu drejtua me një letër kryeministrit britanik James Ramsay MacDonald që mbante njëkohësisht edhe detyrën e ministrit të Punëve të Jashtme si dhe Eric Drummond, Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve. Ajo informonte drejtuesit e lartë të qeverisë britanike se përgjatë kufirit të Shqipërisë me Serbinë, ndodhen me mijëra banorë, jeta e të cilëve ndodhej në rrezik për shkak të zisë së bukës, ndërkaq, qeveria serbe i kërcënonte shqiptarët e këtyre viseve me operacione ndëshkimore, me pretendimin e “vendosjes së rendit”¹⁶. Ajo theksonte se ministri britanik në Durrës e përshkruante aq të rëndë situatën, sa shprehej se “nëse ndihma nuk vinte shpejt, popullsia e malësisë do të shuhej”¹⁷.

Fillimisht, diplomatët britanikë mendonin se rreth 45 mijë banorë që përbënin gjysmën e popullsisë së Luginës së Drinit, ndodheshin në

¹⁵ TNA, FO 371/ 9642, H. C. A. Eyres për Markezimin Curzon të Kedleston, K. G., Durrës, 11 janar 1924, No. 1, (12/412/ 6).

¹⁶ *Po aty*, Letër e M. Edith Durham për Harold Nicolson, Londër, 6 shkurt 1924; *po aty*, Letër e M. Edith Durham për kryeministrin R. MacDonald, Londër, 7 shkurt 1924.

¹⁷ *Po aty*, Letër e M. Edith Durham për Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Londër, 7 shkurt 1924.

gjendje të vështirë¹⁸. Më 19 shkurt 1924, Robert Parr, konsulli britanik në Shqipëri, i paraqiti qeverisë britanike një raport të hollësishëm, në të cilin thuhet se rreth 80 mijë banorë të krahinës së Dibrës, rrezikonin të vdisnin për shkak të urisë. Shtëpitë dhe pasuria e banorëve të kësaj krahine ishte djegur e shkatërruar për herë të tretë nga forcat serbe. Deri në fillim të vitit 1924, rreth 16 mijë banorë kishin vdekur nga uria, të ftohtit dhe nga shkaqe të tjera që lidheshin me kequshqyerjen. Numri i shqiptarëve të vdekur gjatë dy muajve të parë të vitit 1924 në këtë zonë, ishte më i lartë se i së njëjtës periudhë të vitit të shkuar¹⁹. Bashkëshortja e konsullit britanik në Shqipëri, zonja Parr, shprehej se, për shkak të mungesës së ushqimit, popullsia e krahinës së Dibrës ishte detyruar të ushqej me rrënjë dhe boçe të ziera. “Pazari i Peshkopisë i asaj periudhe, nuk meritonte të quhej i tillë, pasi banorët nuk kishin se çfarë të shisnin e të blinin”. Zonja Parr arrinte në përfundimin se e “gjithë popullsia e Dibrës ndodhet në gjendje të keqe, por pjesa në veri të Peshkopisë është në gjendje më të tmerrshme”. Sipas saj, rreth 30 mijë vetë të kësaj pjese të Dibrës vuanin nga uria²⁰.

Shtetasi britanik F. Stroud Read, drejtori i shkollës së njohur “Robert College” në Stamboll, i sapo kthyer nga Shqipëria, shprehej se “njerëz të mbetur pa strehë mbi kokë, të zhveshur e me rroba copë-copë, që rrezikonin të vdisnin nga uria dhe i ftohti, shkonin nga një vend në tjetrin me shpresën se do të gjenin ushqim”. Pjesët më të prekura nga kriza e urisë në Shqipëri, sipas Stroud Rid, ishin: zona nga Lezha në Shkodër, zona e Malësisë së Madhe dhe e Shalës si dhe krahina nga kodrat e Tiranës deri në vijën Strugë – Dibër - Peshkopi²¹. Edhe Margaret Hasluck, theksonte se gjatë muajit tetor 1923, situata kishte arritur deri në atë pikë, sa ajo kishte parë malësorët e Mbishkodrës të hanin barishte dhe gjethe të ziera, për shkak të mungesës së ushqimit²².

¹⁸ *Po aty*, H. C. A. Eyres për Markezimin Curzon të Kedleston, K. G., Durrës, 11 janar 1924, No. 1 (12/412/ 6).

¹⁹ J. Swire, *Shqipëria – Ngritja e një mbretërie...*, f. 329.

²⁰ *TNA*, FO 371/ 9642, Letër e zonjës Parr për zonjën Carnarvon, Durrës, 27 shkurt 1924.

²¹ *Po aty*, Letër e F. Stroud Read për Harold Nicholson në Foreign Office, Londër, 14 shkurt 1924.

²² *Po aty*, Letër e M. Edith Durham për Harold Nicolson, Londër, 6 shkurt 1924; *po aty*, Letër e M. Edith Durham për kryeministrin J. R. MacDonald, Londër, 7 shkurt 1924.

Këndvështrimi i diplomacisë britanike mbi krizën dhe i rrugëdaljes prej saj

Diplomatët britanikë mendonin se faktori kryesor që kishte ndikuar që situata të rëndohej së tepërmi për banorët e Shqipërisë së Veriut, ishte pushtimi i saj nga ushtria serbe në vitet 1920-1921. Si rezultat i luftimeve të shpeshta që kishin ndodhur në krahinën e Dibrës, shumica e shtëpive ishin djegur e shkatërruar, banorët e kësaj krahine, kishin humbur pendët e qeve, ndërkohë që të mbjellat dhe toka e tyre e punëshme ishte dëmtuar rëndë. Që nga ajo periudhë, banorët e këtyre viseve nuk arritën ta merrnin më veten²³. Faktor tjetër që kishte rënduar më tej gjendjen ishte vendimi i Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene për mbylljen e kufirit me Shqipërinë, me pretekstin se bandat shqiptare ndërmerren sulme nga brendësia e kufirit të Shqipërisë në drejtim të territorit të saj. Me këtë pretendim, ajo nuk lejonte eksportimin e misrit në Shqipëri. Ndërkohë, ajo kishte ngritur gjithashtu një mur të papërballueshëm tarifash doganore për shkëmbimet me Shqipërinë²⁴.

Miles W. Lampson i sugjeronte ministrit britanik të Punëve të Jashtme se zgjidhja e kësaj çështjeje, mund të arrihej përmes ndjekjes së këtyre hapave: 1. T'i kërkohej qeverisë shqiptare t'i drejtonte një kërkesë zyrtare Lidhjes së Kombeve; 2. Britania e Madhe të mbështeste kërkesën e Shqipërisë për ndihmë në Këshillin e Lidhjes së Kombeve. Kryeministri britanik (Lordi Parmur) arriti në përfundimin se kursi më i mirë i veprimit nga qeveria britanike ishte sugjerimi i Miles Lampson. Ai paraqiti planin e veprimit që duhej të ndiqte qeveria britanike. Së pari, kriza e urisë që kishte mbërthyer banorët e Shqipërisë së Veriut, duhej trajtuar si një çështje serioze urgjente. Së dyti, veprimtaria e qeverisë britanike do të arrinte sukses, nëse edhe shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Lidhjes së Kombeve do të ofronin një shumë të hollash në ndihmë të Shqipërisë. Së treti, qeveria e Britanisë së Madhe nuk do të

²³ *Po aty*, H. Eyres për Markezin Curzon të Kedleston, K. G., Durrës, 11 janar 1924, No. 1 (12/412/ 6).

²⁴ *Morning Post*, London, 14 April 1924.

mund të siguronte miratimin e ndihmës për Shqipërinë në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, nëse ajo vetë nuk ofronte një kontribut në ndihmë të saj. Së katërti, Ministria e Punëve të Jashtme duhej t'u kërkonte drejtuesve të Ministrisë së Thesarit, që të miratonin një fond prej pesë mijë stërlinash, në rast se shtetet e tjera anëtare të Lidhjes së Kombeve arrinin të mblidhnin shumën prej 15 mijë stërlinash²⁵.

Trajtimi në mënyrë serioze nga qeveria britanike i krizës humanitare të banorëve të Shqipërisë së Veriut

Qeveria britanike e mori seriozisht çështjen e krizës humanitare në Shqipërinë e Veriut. Është më se e qartë se faktori kryesor që nxiti vëmendjen e qeverisë britanike ishin informacionet që ajo mblodhi nga diplomatët dhe veprimtarët britanikë që e njihnin mirë Shqipërinë. Edith Durham paralajmëronte drejtuesit e qeverisë britanike: “Nuk është e domosdoshme t'i tregoj njerëzve që punojnë në Foreign Office se çfarë pasojash mund të sillte një rindezje e flakës së luftimeve në Ballkan”. Ajo përfundonte letrën e saj me fjalët se “nëse paqja do të arrihej me vlerën e shpenzimit të disa mijë stërlinave për blerjen e një sasive misri, do t'ia vlente ky çmim”²⁶.

Në fakt, ishte F. Stroud Rid që zbulonte arsyet e vërteta që duhej të shtynin qeverinë britanike të vepronte për të zbutur krizën e urisë në Shqipëri. *Së pari*, ishin interesat politike britanike për ruajtjen e barazpeshës së forcave në rajonin e Ballkanit. Ai paralajmëroi qeverinë britanike se fara e trazirave të ardhshme gjendej tek kufiri i caktuar për të dy vendet. Popullsia shqiptare e viseve të pjesës lindore të vendit nuk ishte në gjendje të mbante një numër aq të madh refugjatësh. Nëse shqiptarët detyroheshin të kalonin kufirin jugosllav për të blerë ushqime në tregjet natyrale të vendit fqinj, shteti jugosllav që kishte dislokuar forca të shumta në kufi, do të ndërmernte një operacion ushtarak në brendësi të territorit të shtetit shqiptar. Për shkak të invazionit jugosllav

²⁵ TNA, FO 371/9642, Përmbledhje e shënimeve të protokollit të titulluar: “Kriza e urisë në Shqipërinë e Veriut” për relacionin e dërguar nga H. Eyres më 11 janar dhe i marrë në Foreign Office më 21 janar 1924, numri i regjistrimit C1166/1166/90.

²⁶ *Po aty*, Letër e M. Edith Durham për Harold Nicolson, Londër, 6 shkurt 1924; *po aty*, Letër e M. Edith Durham për kryeministrin R. MacDonald, Londër, 7 shkurt 1924.

të Shqipërisë, Italia nuk do të rrinte duarkryq, aq më tepër që ajo kishte në dorë memorandumit e datës 9 nëntor 1921. Përplasja e Italisë me Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene mund të prishte ekuilibrin e forcave dhe të rrezikonte interesat britanike në rajonin e Ballkanit e më gjerë. *Së dyti*, vazhdimi i krizës për një kohë të gjatë në Shqipëri, dëmtonte stabilitetin e brendshëm të shtetit shqiptar. Kjo çënonte interesat që kishte Britania e Madhe në Shqipëri, pasi kompania britanike “Anglo Persian Oil” ishte fokusuar në kërkimin e naftës në Shqipëri. Për shkak të kushteve të vështira ekonomike, që arritën deri në shfaqjen e urisë, disa prej krerëve të fiseve të Dibrës, ishin kthyer në komitë që vepronin jo vetëm në krahinën e tyre, por edhe në zonën e Shqipërisë së Mesme. Vetëm dy vite më parë, një grup kryengritësish nga krahina e Dibrës, pjesërisht për motive politike, por më tepër për shkak të mungesës së ushqimit kishin sulmuar Tiranën, duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit shqiptar²⁷.

Eric Drummond iu përgjigj Harold G. Nicolson-it se rruga më e shpejtë dhe më efektive për të miratuar ndihmën për shqiptarët ishte që qeveria shqiptare t’i drejtonte atij një kërkesë për ndihmë. Për sa i përket mënyrës së administrimit të fondeve, ai sugjeronte se mënyra më e mirë do të ishte ngritja e një komiteti në Shqipëri, i cili të përbëhej nga Dr. Jan Hunger, përfaqësuesit konsullorë të shteteve që do të kontribuonin dhe që kishin përfaqësi diplomatike në Shqipëri²⁸.

Kontributi i veprimtarëve britanikë në Shqipëri – Mospajtimet e brendshme britanike për çështjen e krizës shqiptare

Puna e grupeve të huaja për t’u ardhur në ndihmë shqiptarëve, kishte filluar që në vitin 1922. Një sasi misri që ishte dërguar nga vullnetarët amerikanë, e mbledhur në Evropë dhe Amerikë për zonat e prekura nga uria, nuk kishte rënë në duart e njerëzve që kishin nevojë. Gjatë vitit 1923, M. Edith Durham së bashku me Aubrey Herbert dhe qytetarë të tjerë britanikë, dashamirës të Shqipërisë dhe shqiptarëve, kishin

²⁷ *Po aty*, Letër e F. Stroud Read për Harold Nicolson në Foreign Office, Londër, 14 shkurt 1924.

²⁸ *Po aty*, Eric Drummond, sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve për H. G. Nicolson në Londër, Gjenevë, 5 shkurt 1924.

themeluar në Angli, komitetin e “Albanian Relief Fund” (Fondi i Ndhmës për Shqipërinë), për mbledhjen e të hollave në ndihmë të shqiptarëve²⁹. Deri në këtë periudhë, publiku britanik nuk kishte treguar ndonjë entuziazëm të madh ndaj thirrjes së tyre për ndihmë, për shkak të numrit të kufizuar të njerëzve në Britaninë e Madhe që ishin të interesuar apo që kishin dijeni për Shqipërinë³⁰. Me shumë përpjekje, Edith Durham dhe grupi i miqve të Shqipërisë arritën të mblidhnin një shumë prej 1640 stërlinash, të cilën Robert Parr, konsulli britanik në Shqipëri e shpenzoi për blerjen e një sasive misri. Por, kjo ndihmë, nuk ishte veçse një pikë ujë në krahasim me nevojat e popullsisë shqiptare. Konsulli britanik Parr vlerësoi se së paku 10 mijë deri në 20 mijë stërlina nevojiteshin për të bërë diçka në këtë drejtim³¹.

Në të njëjtën kohë, Eyres ngarkoi konsullin britanik Robert Parr që, së bashku me bashkëshorten e tij, të merreshin me organizimin dhe transportimin e ndihmave për në zonat e prekura nga uria, në emër të “Fondit të Ndhmës për Shqipërinë”³². Misioni i konsullit Parr në Dibër, pati dy objektiva kryesorë: së pari, përcaktimin e mënyrës së shpërndarjes së ndihmave për popullsinë në nevojë; së dyti, për të parë kushtet për akomodimin e tyre në Peshkopi, e cila do të ishte qendra e shpërndarjes së ndihmave për zonën e Dibrës. Një grup vullnetarësh britanikë të përbërë nga Morton Eden, bashkëshortët Parr dhe zonja Stirling u morën me shpërndarjen e ndihmave të mbledhura nga donatorë privatë për prefekturën e Dibrës. Për të shmangur abuzimet sasia e misrit peshohej në Tiranë dhe në Peshkopi³³.

Më datë 13 shkurt 1924, H. Nicolson informonte Ministrinë e Thesarit të Britanisë së Madhe, se afro 80 mijë banorë të Shqipërisë së Veriut, rrezikonin të vdisnin nga uria për shkak se qeveria shqiptare nuk ishte në gjendje që t’u ofronte atyre ndonjë ndihmë substanciale. Në shkresën e saj, theksohej se gjendja në të cilën ndodhej popullsia shqiptare “jo vetëm justifikon ndihmën bamirëse që jepet për qëllime

²⁹ J. Swire, *Shqipëria – Ngritja e një mbretërie...*, f. 329, 337.

³⁰ TNA, FO 371/ 9642, H. C. A. Eyres për Markezin Curzon të Kedleston, K. G., Durrës, 11 janar 1924, No. 1 (12/412/ 6).

³¹ *Po aty*, Letër e M. Edith Durham për Harold Nicolson, Londër, 6 shkurt 1924; *po aty*, Letër e M. Edith Durham për kryeministrin R. MacDonald, Londër, 7 shkurt 1924.

³² *Po aty*, Njoftim i Eyres për Foreign Office, Durrës, 20 shkurt 1924.

³³ *Po aty*, Letër e zonjës Parr për zonjën Carnarvon, Durrës, 27 shkurt 1924.

humane, por ajo ka në një masë të caktuar edhe një rëndësi politike”. Kryeministri MacDonald u kërkoi komisionerëve lordë të Ministrisë së Thesarit, që të shqyrtonin mundësinë e dhënies së një ndihme prej pesë mijë stërlinash, e cila do t’i kalonte Lidhjes së Kombeve në emër të qeverisë britanike³⁴.

Ndryshe nga sa pritej, ndoshta me ndërhyrjen e qarqeve politike të shteteve fqinje, përgjigjja e Ministrisë së Thesarit ishte se Komisionerët Lordë të Thesarit shprehnin “vështirësi të madhe për realizimin e këtij propozimi”. Ndër arsyet kryesore të refuzimit të shumës së kërkuar ishin: Së pari, gjatë viteve të fundit, qeveria britanike kishte shpenzuar shuma të konsiderueshme për qëllime bamirësie. Në këto rrethana, Ministria e Thesarit kishte vendosur të refuzonte kontribute të mëtejshme të kësaj natyre, pasi ato përbënin shqetësim të veçantë për taksapaguesit britanikë. Së dyti, ata ishin kundër propozimit për ndihmë, për arsye se përfituesit e saj do të mbeteshin për një kohë të gjatë të varur nga mbështetja e huaj, si dhe do të ishte mjaft e vështirë që ata t’i ktheheshin punës dhe prodhimit në vendin e tyre. Së treti, meqenëse shtetet e tjera nuk i përmbushnin detyrimet e tyre, ishte bërë zakon që qeveria britanike të detyrohej të merrte përsipër barrën e të tjerëve. Së katërti, ndihma për popullsinë e këtij vendi nuk justifikohej pasi interesat britanike në Shqipëri ishin shumë të vogla. Së pesti, raportet e Dr. Jan Hunger, këshilltarit financiar të qeverisë shqiptare, dëshmonin se metodat financiare që zbatoheshin në Shqipëri ishin tërësisht të papërshtatshme dhe se qeveria shqiptare nuk kishte marrë asnjë masë serioze për të vendosur financat e saj mbi një bazë të shëndoshë. Mosdhënia e ndihmës shihej edhe si një mjet presioni ndaj qeverisë shqiptare për të rikthyer në detyrë Dr. J. Hunger³⁵.

Miles W. Lampson që në këtë periudhë mbante detyrën e nënsekretarit të Shtetit i përgjigjej drejtuesve të Ministrisë së Thesarit se Shqipëria përbënte një rast të veçantë. Drejtuesi i lartë i Foreign Office-it

³⁴ *Po aty*, Harold Nicolson për sekretarin britanik të Thesarit, Londër, 13 shkurt 1924.

* Më 22 prill 1924, Benoit Blinishti i ngarkuar nga qeveria e tij, i përgjigjej Këshillit të Lidhjes së Kombeve se “për shkak të shqetësimit të qeverisë shqiptare lidhur me gjendjen e rëndë financiare të vendit, Asambleja Kushtetuese i kërkoi kësaj qeverie të ndërpriste kontratën e z. Hunger”.

³⁵ *Po aty*, Shkresë e Dhomës së Thesarit për nënsekretarin e Shtetit në Foreign Office, datë 25 shkurt 1924.

justifikonte ndihmën për Shqipërinë, me këto argumente: Së pari, shuma e kërkuar për ndihmë në rastin e Shqipërisë ishte e vogël. Së dyti, qeveria shqiptare gjendej plotësisht jashtë mundësive financiare për të përballuar e vetme krizën e urisë. Së treti, ndihma për Shqipërinë ishte më tepër e një natyre politike se sa humanitare. Miles Lampson garantonte se kërkesa të kësaj natyre nuk do t'i paraqiteshin më Ministrisë së Thesarit në të ardhmen³⁶.

Gjatë një seance diskutimesh në Dhomën e Lordëve të Parlamentit Britanik më datë 5 mars 1924, lordi Lamington theksoi se nëse kriza e urisë në Shqipërinë e Veriut vazhdonte më tej, banorët e saj do të detyroheshin t'ua shisnin pronat e tyre tokësore shtetasve apo qeverisë jugosllave. Kjo do të hapte shtegun e trazirave të mëtejshme midis dy shteteve ballkanike. Ai kërkoi ndërhyrjen e Lidhjes së Kombeve për të zbutur krizën e urisë së banorëve të këtij vendi, por edhe për të penguar me çdo kusht copëtimin e Shqipërisë nga Serbia dhe Greqia. Lordi Parmoor u përgjigj se dëshira e qeverisë britanike ishte që t'i jepte ndihmë maksimale shqiptarëve që vuanin nga uria. Lordi Lamington theksoi se edhe Vatikani do t'i ofronte Shqipërisë, një ndihmë prej katër mijë stërlinash, e cila e çonte shumën në afro 20 mijë stërlina³⁷. Pas këtij debati, përfaqësuesi britanik pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan, Odo Russell, njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme britanike se Papa i kishte dërguar delegatit apostolik në Shqipëri një shumë prej 90 mijë lireta, e cila mund të ishte shpërndarë pa dijeninë e përfaqësuesve të tjerë diplomatikë³⁸.

Qëndrimi i vendosur që vazhdonte të mbante Ministria e Thesarit krijoi shqetësim të madh në mjediset e Foreign Office-it. Nënsekretari i Shtetit, M. Lampson mendonte se për këtë çështje nuk mund të kishte kthim prapa nga ana e qeverisë britanike, pasi veprimet e saj diplomatike tashmë kishin avancuar shumë përpara. Situata në Shqipëri ishte serioze dhe nuk mund të luhej më me këtë çështje. Ai sugjeroi se mënyra më e mirë ishte që kryeministri i vendit, t'i shprehte “një fjalë” kancelarit të Thesarit. Ai argumentonte se shkarkimi nga detyra i këshilltarit financiar

³⁶ *Po aty*, Shkresë zyrtare e Miles Lampson për Ministrinë e Thesarit, F.O., datë 3 mars 1924.

³⁷ *Po aty*, Debati në Dhomën e Lordëve, ndërmjet lordit Lamington dhe lordit Parmoor nga Foreign Office, datë 5 mars 1924.

³⁸ *Po aty*, Njoftim i Odo Russell i legatës britanike në Selinë e Shenjtë për James R. MacDonald, Romë, 31 maj 1924.

nga qeveria shqiptare ishte thjesht një pretekst nga ana e Thesarit, me qëllim që të mos miratonte shumën e kërkuar për Shqipërinë³⁹.

Reagimi i qeverisë shqiptare ndaj krizës humanitare dhe kërkesa e saj për ndihmë në Këshillin e Lidhjes së Kombeve

Krizë humanitare që kishte përfshirë disa krahina të Shqipërisë përkoi me tensionimin e situatës politike brenda vendit. Drejtuesit e politikës shqiptare ishin më të fokusuar tek lufta politike për pushtet, se sa tek kriza humanitare që kishte mbërthyer shqiptarët. Përfaqësuesi britanik pranë Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, A. G. Abraham, i shkruante H. Nicolson, më 6 mars 1924, se drejtuesit e Lidhjes së Kombeve ende nuk kishin marrë një kërkesë për ndihmë nga ana e qeverisë shqiptare. Me tone ironike, ai shprehej se “shqiptarët të preokupuar me ndryshimin e qeverive, e kanë harruar krizën e urisë të shfaqur në mesin e popullsisë së tyre, pasi ndoshta e konsiderojnë atë të parëndësishme”⁴⁰. Ministri britanik Eyres shprehej se megjithëse kriza politike brenda qeverisë shqiptare ishte kthyer në çështje kryesore, ajo kishte në plan t’i telegrafonte Lidhjes së Kombeve për t’i kërkuar ndihmë⁴¹.

Më 7 mars 1924, Benoit Blinishti, përfaqësues i Shqipërisë pranë Lidhjes së Kombeve, i paraqiti sekretarit të Përgjithshëm të saj, kërkesën zyrtare të qeverisë shqiptare për ndihmë. Për shkak të dëmeve të rënda që Shqipëria kishte pësuar nga Lufta e Parë Botërore si dhe të korrave të këqija për dy vite radhazi, rreth 200 mijë banorë të pjesës veriore të Shqipërisë vuanin nga uria. Mbështetur në arsye humanitare, qeveria shqiptare i bënte thirrje Lidhjes së Kombeve për ndihmë, që të parandaloheshin humbjet e mëtejshme njerëzore⁴². Më 13 mars 1924, përfaqësuesi shqiptar B. Blinishti paraqiti para Këshillit të Lidhjes së

³⁹ *Po aty*, Protokoll mbi kontributin e ndihmës së qeverisë së Madhërisë së Tij për zbutjen e urisë në Shqipërinë e Veriut, shënimi i Miles Lampson, datë 5 prill 1924.

⁴⁰ *Po aty*, Përfaqësuesi britanik në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, A. G. Abraham për H. Nicolson, Gjenevë, 6 mars 1924.

⁴¹ *Po aty*, Njoftim i Eyres për Foreign Office, Durrës, 14 shkurt 1924.

⁴² *Po aty*, Letër e kryetarit të delegacionit shqiptar të akredituar pranë Lidhjes së Kombeve drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, 7 mars 1924.

Kombeve, argumentet që justifikonin kërkesën e Shqipërisë për ndihmë. Ai theksoi faktin se të gjitha shtetet e pavarura të Ballkanit kishin përfituar ndihmë në fillimet e jetës së tyre, ndërsa Shqipëria nuk kishte marrë as ndihmën më të vogël financiare nga jashtë. Edhe pas Luftës së Parë Botërore, ajo nuk përfitoi asnjë lloj ndihme në formë reparacioni, për humbjet dhe dëmtimet e shumta që kishte pësuar gjatë kohës së pushtimit të saj. B. Blinishti shprehu mirënjohjen e qeverisë shqiptare dhe të popullit shqiptar për shërbimet e dobishme që Lidhja e Kombeve i kishte ofruar Shqipërisë në momentet më kritike të historisë së saj.

Në raportin e mbajtur në mbledhjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve, lordi Parmoor theksonte se për të tejkaluar këtë krizë të rëndë duheshin rreth 15 mijë stërlina. Qeveria britanike ishte e vendosur të ofronte një shumë prej pesë mijë stërlinash. Përfaqësuesi italian Salandra propozoi që të akordohej një shumë prej 50 mijë frangash në ndihmë të Shqipërisë nga fondet për shpenzime të paparashikuara të Lidhjes së Kombeve. Ky propozim u përfshi në rezolutën që iu drejtua Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve⁴³. Këshilli vendosi akordimin e shumës prej 50 mijë frangash zvicerane nga fondi 26, me emërtimin: “Për shpenzime të paparashikuara që kërkojnë votim të veçantë nga Këshilli” në buxhetin e vitit 1924 të Lidhjes së Kombeve⁴⁴.

Cili ishte organizatori i shpërndarjes së ndihmave në Shqipëri?

Ministria e Thesarit kërkoi përfshirjen e Dr. J. Hunger si person përgjegjës për shpërndarjen e ndihmës për Shqipërinë. Mirëpo, A. G. Abraham, përfaqësuesi britanik pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, shprehej se “megjithëse Hunger ishte një zotëri i vërtetë, ai nuk ia kishte dalë që të imponohej dhe të siguronte

⁴³ *Po aty*, Ekstrakt nga protokollin provizor i mbledhjes së gjashtë të Sesionit të 28-të të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, datë 13 mars 1924; *Po aty*, Njoftim i Cadogan përfaqësuesit të Britanisë së Madhe në Këshillin e Lidhjes së Kombeve për FO, Gjenevë, 14 mars 1924.

⁴⁴ *Po aty*, Raport i paraqitur Këshillit të Lidhjes së Kombeve nga lordi Parmoor i titulluar “Krizja e urisë në Shqipërinë e Veriut”, datë 13 mars 1924; *po aty*, Rezolutë e titulluar “Krizja e urisë në Shqipërinë e Veriut”, propozuar nga lordi Parmoor për Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, datë 14 mars 1924.

dinjitetin e tij personal në Shqipëri”. Në këto rrethana, ai mendonte se Hunger nuk ishte “i përshtatshëm për këtë punë”⁴⁵. Me kërkesë të Komitetit të Përbashkët të Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të Lidhjes së Shoqatave të Kryqit të Kuq, Këshilli i Lidhjes së Kombeve në sesionin që u mbajt më 13 mars 1924, caktoi profesor Eugène Pittard nga Universiteti i Gjenevës si person përgjegjës për administrimin e ndihmave për Shqipërinë⁴⁶.

Në fakt, Britania e Madhe dhe grupet britanike të interesit synonin caktimin e një shtetasi britanik në këtë detyrë. Më 15 mars 1924, Eglantyne Jebb nga Fondi “Save the Children” i kërkoi lordit Parmoor, përfaqësuesit të Britanisë së Madhe në Lidhjen e Kombeve të interesohet nëse në Foreign Office pranohej mendimi që Stroud Rid të ngarkohej me këtë detyrë. Emri i S. Read ishte sugjeruar nga drejtori ekzekutiv i “Save the Children Fund”. E. Jebb kërkonte të informohej nga kryeministri “nëse Lidhja e Kombeve favorizon këtë plan apo ka ndonjë plan tjetër”⁴⁷. Lord Parmoor iu përgjigj asaj se, tashmë Këshilli i Lidhjes së Kombeve e kishte përcaktuar agjensinë, e cila do të merrej me shpërndarjen e ndihmës në Shqipëri. Edhe H. Eyres i sugjeronte Ministrisë së Punëve të Jashtme që Stroud Read t’i propozohej Lidhjes së Kombeve, pasi ai ishte rekomanduar nga organizata “Save the Children” si një “njeri i shkëlqyer për atë punë”. Ai sugjeronte gjithashtu se çdo komisioner para se të fillonte punën për shpërndarjen e ndihmave, do të ishte mirë që të konsultohet me legatën britanike në Durrës. Ministri britanik në Durrës i kërkonte Foreign Office, shmangien e shqiptarëve nga shpërndarja e ndihmave⁴⁸.

Eric Drummond informonte Miles Lampson se, krahas Eyres, edhe Miss E. Durham i kishte sugjeruar emrin e Stroud Rid për shpërndarjen e ndihmave. Ai kishte biseduar me profesor Pittard, çështjen e përfshirjes së tij në grupin e administrimit të ndihmave në Shqipëri. Më tej, E. Drummond i kishte kërkuar Pittard-it që të konsultohet me ministrin

⁴⁵ *Po aty*, Përfaqësuesi britanik A. G. Abraham në Lidhjen e Kombeve për H. Nicolson, Gjenevë, 6 mars 1924.

⁴⁶ TNA, FO 371/ 9643, Notë zyrtare e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, drejtuar Foreign Office, Gjenevë, 25 mars 1924.

⁴⁷ *Po aty*, Letër e zonjushës Eglantyne Jebb nga Fondi “Save the Children” për lord Parmoor, përfaqësues i Britanisë së Madhe në Lidhjen e Kombeve, Londër, 15 mars 1924.

⁴⁸ *Po aty*, Njoftim telegrafik i Eyres për Foreign Office, Durrës, 25 mars 1924.

Eyres dhe konsullin Parr në Shqipëri mbi çështjen e organizimit të ndihmave. Në këto rrethana, Drummond mendonte se kishte bërë gjithçka që ishte praktikisht e mundur mbi këtë çështje⁴⁹.

Shuma e ndihmës së mbledhur - Shtetet dhe organizatat që kontribuan për Shqipërinë

Deri në muajin prill 1924, krahas shumës prej 50 mijë franga zvicerane (2 000 stërlina) të miratuar nga Lidhja e Kombeve, ndihmës së Italisë me 500 mijë lireta (5.100 stërlina) dhe të Çekosllovakisë me 500 stërlina, apelit për ndihmë i ishin bashkuar edhe Spanja me 10 mijë peseta (300 stërlina), disa qytetarë amerikanë kishin dhuruar 10 mijë dollarë (2 300 stërlina), Fondi Ndërkombëtar "Save the Children" kishte ndihmuar me 600 stërlina, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar me pesë mijë franga zvicerane (200 stërlina), Kryqi i Kuq i Rumanisë me 10 mijë lei (10 stërlina). Shuma e përgjithshme e ndihmës së mbledhur ishte 11 010 stërlina⁵⁰.

Qeveria britanike ishte mjaft e interesuar që nisma e saj në ndihmë të banorëve të Shqipërisë të mos dështonte, pasi në të kundërt vihej në dyshim kredibiliteti i saj në sytë e opinionit ndërkombëtar. Edhe në aspektin e brendshëm, ajo synonte të merrte miratimin e Ministrisë së Thesarit dhe të Parlamentit Britanik për shumën e premtuar publikisht nga Britania e Madhe në Këshillin e Lidhjes së Kombeve. Meqenëse Lidhja e Kombeve e kishte përmbushur detyrimin e saj, ky fakt me sa duket ndikoi që t'u sosej durimi drejtuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kryeministri britanik ngarkoi nënsekretarin e Shtetit, Miles Lampson, t'i kërkonte prerë sekretarit britanik të Thesarit që shuma prej pesë mijë stërlinash, të jepej pa vonesë, pasi qeveria britanike ishte e vendosur të mos tërhiqej nga premtimi i saj⁵¹. Përballë presionit të kryeministrit britanik, Ministria e Thesarit u detyrua të tërhiqej⁵².

Më 5 qershor 1924, Eric Drummond njoftonte se ndihmës për Shqipërinë, i shtohej kontributi prej pesë mijë stërlinash i Britanisë së

⁴⁹ *Po aty*, Letër e Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve për Miles Lampson, Gjenevë, 31 mars 1924.

⁵⁰ *Po aty*, Telegram i Sir E. Drummond për Foreign Office, Gjenevë, 24 prill 1924.

⁵¹ *Po aty*, Shkresë e Miles W. Lampson për sekretarin e Thesarit, FO, 10 prill 1924.

⁵² *Po aty*, Shkresë e Ministrisë së Thesarit për nënsekretarin e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, datë 12 prill 1924.

Madhe. Rumania kishte ofruar një sasi misri, ndërsa Kryqi i Kuq italian ofronte rroba për banorët në nevojë. Më 7 qershor 1924, edhe Suedia i ishte përgjigjur thirrjes për ndihmë, duke ofruar 10 mijë korona suedeze⁵³. Më 11 qershor 1924, në protokollin e Këshillit të Lidhjes së Kombeve raportohej se deri atëherë ishte mbledhur një shumë prej 16.535 stërlina ndihma për Shqipërinë. Përfaqësuesi francez, Clauzel, informoi Këshillin e Lidhjes së Kombeve se komiteti francez i “Fondit Shpëtoni Fëmijët” nën kryesinë e zonjës Dubost, kishte mbledhur ndihma, një pjesë e të cilave ishte shpërndarë në Shqipëri. Ndërkaq, ky komitet, nën drejtimin e Justin Godart, shpresonte që deri në fund të muajit qershor 1924, të gjendej një mundësi tjetër për sigurimin e ndihmave të tjera⁵⁴.

Qeveria jugosllave vazhdoi ta mbante të mbyllur kufirin me Shqipërinë. Me qëndrimin që mbajti, ajo dëshmoi edhe njëherë se sa e pamëshirshme ishte ndaj shqiptarëve. Shkatërrimet e kryera prej ushtrisë së saj në viset e Shqipërisë si dhe bllokada ekonomike ndaj shqiptarëve e kishin shtuar urretjen e tyre. Qëndrimi i saj e kishte bërë më të mprehtë krizën e urisë në mesin e banorëve të këtyre viseve. Pas një kundërshtimi të gjatë, më 15 prill 1924, qeveria jugosllave njoftoi se kishte vendosur të hapte kufirin me Shqipërinë për të lejuar kalimin e sasisë së grurit të blerë nga Lidhja e Kombeve⁵⁵.

Hartimi i planit për shpërndarjen e ndihmave për zonat e prekura nga uria

Nga muaji mars deri në javën e tretë të muajit prill 1924, profesor Pittard u njoh nga afër me situatën në rajonin e prekur nga uria. Vendet më të prekura nga kriza e urisë sipas E. Pittard, ishin prefekturat e Dibrës, Kosovës dhe të Shkodrës. Popullsia e prefekturave të Kosovës dhe të Shkodrës me një numër prej rreth 60 deri në 70 mijë banorësh, kishte arritur në atë gjendje, sa ajo ishte duke konsumuar sasinë e farës së misrit të parashikuar për mbjellje në stinën e pranverës, si dhe po

⁵³ *Po aty*, Shtesë për raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve mbi rezultatet e arritura pas thirrjes për ndihmë, Gjenevë, 5 qershor 1924.

⁵⁴ *Po aty*, Protokoll i mbledhjes së parë të datës 11 qershor 1924 i sesionit 29 të Këshillit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

⁵⁵ *Po aty*, Bashkëbisedim i ministrit të qeverisë serbo-kroato-slllovene me nënsekretarin e Shtetit në Foreign Office, datë 15 prill 1924.

shisnin bagëtitë e fundit të tyre, për të blerë drith. Pitard mendonte se kriza e madhe e urisë e këtij viti lidhej me të korrat e këqija, me shkatërrimet e luftës, por më tepër ajo lidhej me sistemin e taksave.

Me shumën prej dhjetë mijë stërlinash të mbledhura deri në atë kohë, mund të blihej një sasi misri, e cila e ndarë në racione nga 20-25 kilogram misër për frymë, mund të mbulonte nevojat vetëm për banorët e prefekturës së Shkodrës, e cila kishte një popullsi prej 50-60 mijë banorësh. I gjendur në këto rrethana, Pitard kërkoi me urgjencë, shtimin e fondeve, për të plotësuar nevojat më të domosdoshme të pjesës së mbetur të popullsisë shqiptare të prekur nga uria. Edhe shuma e përgjithshme prej 20 mijë stërlinash, që kishte parashikuar Lidhja e Kombeve për t'u akorduar si ndihmë për Shqipërinë, nuk mjaftonte më shumë se për racionet ushqimore të një personi, për një periudhë 6 javore, ndërkohë që derisa të afrohej sezoni i të korrave duheshin edhe 12 javë të tjera⁵⁶.

Në këndvështrimin e Eugèn Pittard, varfëria ekstreme dhe kriza e stërgjatur ekonomike e Shqipërisë mund të kalohej përmes një plani veprimi, të ndarë në dy faza kryesore: Faza e parë, ishte ndërhyrja emergjente, që synonte kapërcimin e krizës së urisë si dhe shpëtimin e banorëve të Shqipërisë së Veriut nga vdekja masive. Faza e dytë, ishte një ndërhyrje afatgjatë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe popullsisë së këtij vendi. Sipas tij, ndërhyrja emergjente ishte e rëndësishme, por më e rëndësishme për Shqipërinë dhe komunitetin ndërkombëtar ishte zhvillimi afatgjatë i këtij vendi. Ishte kjo arsyeja kryesore, që ai ngulte këmbë në mendimin se popullsia shqiptare duhej me çdo kusht që të mbështetej në forcat dhe veprimtarinë e saj prodhuese. Pas kapërcimit të krizës humanitare, ai mendonte se duhej të shqyrtohej mundësia e furnizimit të banorëve me një sasi farërash, vegla pune bujqësore si dhe një numër bagëtish nga raca të zgjedhura⁵⁷.

Pas analizës së tij në terren, profesor Pittard mori disa vendime: 1. Popullsisë shqiptare që gjendej në nevojë, t'i shpërndahej vetëm misër, meqenëse ai ishte ushqimi i tyre tradicional; 2. Të organizoheshin katër

⁵⁶ *Po aty*, Njoftim i Eyre-s për sekretarin britanik të Shtetit James Ramsay MacDonald, Durrës, 21 prill 1924.

⁵⁷ *Po aty*, Raporti i parë i profesor Pittard mbi krizën e urisë në Shqipërinë e Veriut, Gjenevë, 28 prill 1924.

qendra shpërndarjeje: Shkodra dhe Shëngjini të ishin qendra shpërndarjeje për pjesën perëndimore të vendit, Kukësi dhe Kolgecaj të ishin qendrat e shpërndarjes së ndihmës për pjesën lindore të vendit; 3. Të ndaheshin racione në masën 20 kilogramë për frymë, sipas listave të hartuara nga autoritetet lokale të vendit. Listat përmbanin një numër prej 40 mijë banorësh për pjesën perëndimore dhe 12 mijë frymë për pjesën lindore të vendit. Ndërkohë, profesor Pittard porositi blerjen e një sasive prej 900 mijë kilogram misër “farë Besarabie”⁵⁸.

Si u realizua shpërndarja e ndihmave në Shqipëri?

Më 11 qershor 1924, Këshilli i Lidhjes së Kombeve i kërkoi profesor Pittard që të kthehej sa më shpejt në Shqipëri dhe të vazhdonte punën e tij për administrimin e fondit të ndihmave të mbledhura nga Lidhja e Kombeve⁵⁹. Më 14 qershor 1924, edhe qeveria e Fan Nolit i kërkoi Lidhjes së Kombeve, që të rifillonte pa vonesë procesi i shpërndarjes së ndihmave. Meqenëse profesor Pittard e pati të pamundur të kthehej në Shqipëri, për shkak të angazhimeve të tij profesionale, në qershor të vitit 1924, M. Henry Cuéned dhe M. Schlemmer, nga Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, u caktuan për të administruar fondet dhe për të përfunduar shpërndarjen e ndihmave në Shqipëri, sipas planit dhe marrëveshjeve të hartuara nga Pittard.

M. Henry Cuéned së bashku me M. Schlemmer arritën në Durrës më 24 qershor 1924. Ata morën garanci nga qeveria se do të lëshoheshin urdhra, për të parandaluar konfiskimin e sasisë së misrit të ofruara në ndihmë popullsisë së varfër të prekur nga kriza, si gjobë për detyrimet e papaguara ndaj shtetit. Komisioni kërkoi që sasia e misrit e blerë nga profesor Pittard, që gjendej e magazinuar në Bari, të nisej menjëherë për në Shëngjin. Komisioni i ndihmave i Lidhjes së Kombeve vendosi të fillonte punë pa humbur kohë dhe të plotësonte kërkesat, aq sa lejonin burimet e Lidhjes së Kombeve.

⁵⁸ *Po aty*, Raport i Henri Cuénod drejtuar Këshillit të Lidhjes së Kombeve mbi ndihmën e ofruar në zonat e prekura nga kriza e urisë në Shqipërinë e Veriut, Gjenevë, 29 gusht 1924.

⁵⁹ *Po aty*, Protokoll i mbledhjes së parë të datës 11 qershor 1924 i sesionit 29 të Këshillit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

Më datë 27 qershor 1924, Komisioni i Shpërndarjes së Ndhimave arriti në zonën e kufirit midis Shqipërisë dhe Serbisë. Ai arriti në përfundimin se mënyra më e mirë për të plotësuar nevojat e popullsisë së kësaj prefekturë, ishte që të blihej një sasi misri nga Serbia. Më 28 qershor, anëtarët e komisionit u ndodhën në Pukë, ku u vendos që një pjesë e fshatrave të kësaj zone të merrnin ndihmën e parashikuar në Shkodër, ndërsa pjesa tjetër në Kukës, pasi një pjesë e banorëve të kësaj nënprefekturë e kishin më afër Kukësin. Më 29 qershor komisioni arriti në Kukës, ku, në bashkëpunim me autoritetet vendore, u vendos që pika e shpërndarjes së ndihmave për këtë zonë të transferohej nga Kolgecaj në Qafë Morinë. Më 30 qershor 1924, komisioni shkoi në qytetin e Prizrenit. M. Schlemmer shkoi në Beograd dhe arriti të siguronte lejen për kalimin e drithit në kufi si dhe kërkoi ndihmën e premtuar nga qeveria jugosllave në Lidhjen e Kombeve për transportimin e sasisë së misrit të blerë atje.

Puna për shpërndarjen e ndihmave filloi më 5 korrik dhe përfundoi më 14 gusht 1924. Gjatë punës, komisioni u detyrua të shtonte numrin e banorëve të përfshirë në skemën e ndihmës për krahina, si Dukagjini, Mirdita dhe Malësia e Madhe. Komisioni pranoi sugjerimet e autoriteteve vendore të Shkodrës për të përfshirë edhe një numër banorësh të tjerë në skemën e ndihmës, por u vendos që racioni i ndihmës për banorët e qytetit të pakësohej në 15 kilogramë për frymë. Sasia e misrit të shpërndarë ishte: 226 810 kilogram për banorët e qytetit të Shkodrës; 87.875 kilogram për banorët e fshatrave të periferisë së Shkodrës; 195.460 kilogram për banorët e Malësisë së Madhe; 102.920 kilogram për banorët e nënprefekturës së Dukagjinit; 81.960 kilogram për banorët e nënprefekturës së Pukës; 164.150 kilogram për banorët e nënprefekturës së Mirditës; 110.900 kilogramë për banorët e nënprefekturës së Lezhës; 20.000 kilogram për banorët e rrethit të Matit.

Komisioni bleu në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene një sasi të përgjithshme prej 244.000 kilogram misër, për banorët e viseve verilindore shqiptare. Meqenëse 44.000 kilogram misër u siguruan në Prizren, shpërndarja e kësaj sasie filloi menjëherë. Qeveria jugosllave siguroi transportin pa pagesë përmes transportit hekurudhor të sasisë prej 200.000 kilogram. Shpërndarja e ndihmave filloi më 15 korrik 1924 në Kukës, ndërsa më datë 20 korrik 1924, puna nisi në Qafë Morinë. Detyra e shpërndarjes së ndihmave përfundoi më 16 gusht 1924 në të dy pikat e shpërndarjes. Edhe në Qafë Morinë u shfaq problemi i mospërfshirjes të

mjaft fshatrave të këtij rajoni në listat e autoriteteve vendore, kështu që pati ankesa. Ndërsa, në Kukës u zhvilluan mitingje proteste nga banorët e kësaj zone. Me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, komisioni ra dakord për reduktimin e sasisë së racioneve për çdo frymë, me qëllim që të kënaqej një numër sa më i madh banorësh. Nga sasia e përgjithshme e blerë prej 244.000 kilogram misër, 84.000 kilogramë iu shpërndanë banorëve në Qafë Morinë dhe 160.000 kilogramë iu shpërndanë banorëve në Kukës.

Meqenëse një shumë prej 10 mijë frangash zvicerane nuk u përdor nga komisioni, Henry Cuénod i sugjeroi Këshillit të Lidhjes së Kombeve që ajo të përdorej për blerjen dhe shpërndarjen e sasive të ilaçit të kininës, për të luftuar sëmundjen e malaries që po përhapej së tepërmi tek banorët e zonave perëndimore.

Përpjekja e Lidhjes së Kombeve për të kapërcyer krizën humanitare të shfaqur në mesin e popullsisë së Shqipërisë së Veriut, rezultoi e suksesshme. Një numër i madh njerëzish që vuanin nga uria, arritën të shpëtonin nga vdekja. Ndhimja e ofruar nga Lidhja e Kombeve për banorët e Shqipërisë së Veriut arriti në kohën kur atyre u kishin mbaruar rezervat e drithit të vitit të kaluar, ndërkohë që ende nuk kishte ardhur sezoni i të korrave për vitin 1924. Shpërndarja e sasisë së misrit në një kohë të shpejtë u mundësoi banorëve që të siguronin mbijetesën e familjeve të tyre, të shpëtonin bagëtinë si dhe t'i kushtonin vëmendje më të madhe kulturave bujqësore të mbjella⁶⁰.

Natyrisht, puna për shpërndarjen e ndihmave nuk ishte tërësisht e përsosur. Vështirësitë lidheshin kryesisht me faktin se ndihma duhej të shpërndahej me shpejtësi të madhe. Në këtë drejtim kishin ndikuar edhe faktorë të tjerë, si gjendja politike e paqëndrueshme brenda vendit si dhe mungesa e rrugëve të transportit. Konsulli Parr i raportonte qeverisë së tij se, komisioni i administrimit të ndihmës së Lidhjes së Kombeve ishte penguar nga ana e tregtarëve, spekulatorëve të drithit dhe të disa zyrtarëve shqiptarë, të cilët synonin që sasia e misrit të mos arrinte në duart e popullsisë së varfër⁶¹. Ministri britanik në Durrës, kishte të dhëna

⁶⁰ FO 371/ 9643, Raport i Henri Cuénod drejtuar Këshillit të Lidhjes së Kombeve mbi ndihmën e ofruar në zonat e prekura nga kriza e urisë në Shqipërinë e Veriut, Gjenevë, 29 gusht 1924.

⁶¹ *Po aty*, Konsulli britanik Parr për James Ramsay MacDonald, Durrës, 15 gusht 1924.

se “vetëm një e treta e sasisë së misrit arriti në duart e popullsisë së prekur nga kriza”⁶².

S u m m a r y

THE HUMANITARIAN CRISIS OF 1923-1924 IN THE REGIONS OF NORTH ALBANIA – THE ASSISTANCE OF THE BRITISH GOVERNMENT AND OF THE LEAGUE OF NATIONS

The famine crisis that swept across the inhabitants of the North Albanian regions showed up in 1922, went on during 1923 and reached its climax in the first half of 1924. About 200.000 inhabitants of North Albania were touched by this heavy humanitarian crisis. The political borders that were imposed to Albania in 1913, the destructions and requisitions done by the fighting forces during World War I, the occupation of North Albania by the Serbian army in 1920-1921 and the decision of the Kingdom of the Serbs, Croats and Slovenes to close the border to Albania were the main reasons of this crisis.

The British government treated seriously the humanitarian crisis of North Albania. It offered a sum of 5.000 pound sterling and urged the other countries of the Council of the League of Nations to contribute in helping Albania. The serious engagement of the British government had to do with humanitarian motives but also with its political interests in Albania. Till June 11th 1924 a sum of 16.535 pound sterling was raised to help Albania.

The aids distribution in the areas affected by the famine crisis began on July the 5th and it ended on August the 16th 1924. An amount of 990.075 kilograms of maize was distributed to the inhabitants of the Western Albanian regions and an amount of 244.000 kilograms of maize was distributed to the inhabitants of the North-Eastern regions of Albania. Due to the offered assistance by the League of Nations a considerable number of people in North Albania made it to survive.

⁶² *Po aty*, Relacion i ministrit britanik Eyre-s për James Ramsay MacDonald në Londër, Durrës, 25 shtator 1924.